VENDIM
Nr. 281, datë 25.9.2023

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "DRAGOBIA ENERGY" SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT TË ERE-s, PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SAJ SI MJET (BARRË SIGURUESE) PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 5, 8 dhe 9, pikat 4 dhe 5, dhe 10, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.9.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2048/5 prot., datë 21.9.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Dragobia Energy' sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve",

konstatoi se:

- Shoqëria "Dragobia Energy" sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Cerem" dhe "Dragobi", me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 17, datë 6.2.2016, dhe në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 98, datë 16.4.2021.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2048 prot., datë 21.8.2023, i licencuari "Dragobia Energy" sh.p.k. dhe ortaku i vetëm i saj/koncesionari "Gener 2" sh.p.k., kanë paraqitur kërkesën për dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë koncesionare "Dragobia Energy" sh.p.k. si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj palëve të treta, konkretisht ndaj shoqërive "Banka Amerikane e Investimeve" sh.a., "Banka e Tiranës" sh.a. dhe "Union Bank" sh.a.
- ERE, me shkresën nr. 2048/2 prot., datë 7.9.2023, i është drejtuar shoqërisë "Dragobia Energy" sh.p.k. duke evidentuar dokumentacionin e konstatuar të munguar, të këtij aplikimit. Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2048/3 prot., datë 11.9.2023, shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacionin e kërkuar.
- Rezulton se shoqëria "Dragobia Energy" sh.p.k. plotëson kërkesat si vijon:
- Neni 8, pika 1, germat: "a", "b", "c", "d", "e";
- Neni 8, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d", "e".

Shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve".

- Shoqëria "Dragobia Energy" sh.p.k. ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s për sa i përket pagesave rregullatore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë "Dragobia Energy" sh.p.k. si mjet (barrë siguruese), për garantimin e detyrimit ndaj shoqërive "Bankës Amerikane të Investimeve" sh.a., "Bankës së Tiranës" sh.a. dhe "Union Bank" sh.a.

2. Dhënia e autorizimit nga ana e ERE-s, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, nuk e zhvesh shoqërinë "Dragobia Energy" sh.p.k. nga detyrimi për të marrë miratimin nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe organeve të tjera përkatëse nëse kërkohet sipas akteve ligjore në fuqi në çdo moment që ndodh transferimi.

3. Shoqëria të njoftojë ERE-n pas shlyerjes së plotë të kredisë dhe heqjes së barrës siguruese mbi kuotat e saj.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Dragobia Energy" sh.p.k., shoqërinë "Gener 2" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti